



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 416/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.06.2017 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ana Dulo” p.f., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-74951-03-29-2017, me objekt “Një Piano për Qytetin e Artit (Dega Ekonomike e Kultures)”, me fond limit 3.333.330 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.04.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues:

“La Boheme” sh.p.k.
Adresa: Rruga e Elbasanit, Qendra e Biznesit, Ndërtesa Nr. 45,
Pranë Ambasadës Amerikane, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Shkodër
Adresa: Rruga “13 Dhjetori”, Nr. 1, Shkodër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.03.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-74951-03-29-2017, me objekt “Një Piano për Qytetin e Artit (Dega Ekonomike e Kultures)”, me fond limit 3.333.330 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.04.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 10.04.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 12.04.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Ana Dulo” p.f. 2.980.000 lekë (pa TVSH), kualifikuar
2. “La Boheme” sh.p.k. 2.990.000 lekë (pa TVSH), kualifikuar

II.4. Në datën 12.04.2017 operatori ekonomik “La Boheme” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin në vend të dytë të ofertës së tij ekonomike në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Në datën 14.04.2017 operatori ekonomik “La Boheme” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Ana Dulo” p.f. në procedurën e mësipërme të prokurimit”. Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...]

Shoqëria jonë po paraqet këtë ankesë duke mos pranuar kualifikimin e personit fizik “Ana Dulo” p.f., sepse ne kemi argumenta se kualifikimi i këtij operatori është bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik dhe kriteret kualifikuese të DST. Shoqëria jonë që nga viti 1996, në mënyrë të pandërprerë ushtron aktivitetin në fushën e tregëtimit të veglave muzikore, pajisjeve audio dhe të ndriçimit për tregun dhe institucionet kulturore artistike të vendit. Kompania jonë ka realizuar shumë projekte në institucionet kulturore dhe artistike të vendit. Rasti tipik është kualifikimi i gabuar i personit fizik “Ana Dulo” që nuk plotëson kriteret kualifikuese sikurse përcaktohet në nenin 53 të LPP. Konkretisht në “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” të dhëna në DST, për “Kapacitetin ekonomik dhe financiar” në pikën 2.2 kërkohet:

“1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer xhiro mesatare vjetore për vitin 2014, 2015, 2016 në një vlerë prej 3. 333. 330 (Tremilion e treqind e tridhjetë e tre mijë e tridhjetë e tre) lekë. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë këtyre viteve.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2014, 2015 dhe 2016.”

Ne po ju vëmë në dispozicion dokumentin që vërteton se personi fizik “Ana Dulo” nuk i ka plotësuar këto kriteret kualifikuese, sepse nga verifikimi i Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, I cili është online në eëbsite-in e Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se ky operator ekonomik është krijuar në datën 04.03.2016. Është mëse e qartë se personi fizik “Ana Dulo” nuk plotëson kriterin për:

- Dorëzimin e kopjeve të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2014, 2015, 2016.*
- Dorëzimin e vërtetimit nga Dega e Tatim Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve 2014, 2015, 2016.*

Për sa më sipër, në zbatim të LPP dhe VKM 914 kërkohet: 1. Të bëhet pezullimi i procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës tone dhe të verifikohen mangësitë që kemi relatuar; - Të anulohet vendimi i KVO-së dhe të bëhet skualifikimi i operatorit ekonomik përson fizik “Ana Dulo” Tiranë, që nuk plotëson kriteret kualifikuese, si dhe të shpallet fituese shoqëria jonë që është e kualifikuar.

II.4.2. Në datën 24.04.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 5162/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën me arsyetimin si më poshtë vijon:


[...]

Me marrjen e ankesës procedura e prokurimit është pezulluar me vendim të Titullarit të Autoritetit Kontraktor deri në shqyrtimin e saj. Nga verifikimi i Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB datë

04.04.2017 rezulton se subjekti “Ana Dulo” person fizik është regjistruar si subjekt pranë QKB me datë 04.03.2016, prandaj ky subjekt për vitin 2014 – 2015 nuk ka ekzistuar dhe nuk ka ushtruar aktivitet e si pasojë nuk mund të paraqiste bilancet dhe xhiron për këto vite në kushtet kur nuk ka ekzistuar fare si subjekt. LPP nuk përjashton në asnjë nen të tij pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik subjektet e reja dhe të sapokrijuara bile nxit pjesëmarrjen e tyre në këto procedura, mjafton që ato të kenë kapacitetet teknike të nevojshme për të realizuar me sukses kontratën. Në rastin konkret do ti kërkohet vetëm bilanci dhe dhe xhiroja për vitin 2016 gjë të cilën e ka sjellë. Mosparaqitja e bilanceve dhe xhiros së dy viteve 2014 – 2015 nuk mund të përbëjë shkak për skualifikimin pasi i bie që në këtë procedurë të marrin pjesë vetëm subjektet që janë krijuar përpara këtyre viteve në kundërshtim me frymën e ligjit për prokurimin publik i cili nxit pjesëmarrjen e bizneseve të vogla dhe të reja. Ky operator me eksperiencën e tij në këtë fushë e justifikuar kjo me furnizime të ngjashme me subjekte prestigjioze bind autoritetin kontraktor se mund të realizojë kontratën me sukses në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

II.4.3. Në datën 26.04.2017 operatori ekonomik “La Boheme” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ana Dulo” p.f. në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 6437 prot., datë 04.05.2017, protokolluar me tonën në datën 08.05.2017, me objekt “Informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.



Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “La Boheme” sh.p.k. se “operatori ekonomik “Ana Dulo” p.f. nuk plotëson kriteret kualifikuese sikurse përcaktohet në nenin 53 të LPP. Konkretisht në “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” të dhëna në DST, për “Kapacitetin ekonomik dhe financiar” në pikën 2.2 kërkohet:

“1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer xhiro mesatare vjetore për vitin 2014, 2015, 2016 në një vlerë prej 3.333.330 lekë”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit të publikuara në sistemin e prokurimeve elektronike, në shtojcën 7, “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin si më poshtë:

[...]

1. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer xhiro mesatare vjetore për vitin 2014, 2015, 2016 në një vlerë prej 3 333 330 (Tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e tridhjetë e tre) lekë. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë:*

a) Vërtetim nga Dega e Tatim - Taksave për xhiron e realizuar gjatë këtyre viteve.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar :

- Pasqyrat Financiare të Vitit 2016
- Vërtetim Nr.16239/1 Prot datë 05.04.2017 lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me anë të së cilës vërtetohet se: *Tatimpaguesi person fizik/juridik Ana Dulo në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitur në vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:*
 - o *Viti 2016* *2.102.810 lekë*
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar me anë të së cilës provohet se subjekti “Ana Dulo” p.f. është themeluar në datën 04.03.2016

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. [...]*”

Në nenin 26 “Kontrata e Mallrave” pika 5 gërma “b” e VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet [...]

III.1.4. Referuar ekstraktit të regjistrimit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit rezulton se, operatori ekonomik “Ana Dulo” p.f. është regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar në datën 04.03.2016. Nisur nga kjo, xhiro për vitet 2014, 2015, në përlllogaritje të mesatares, do të konsiderohet në shifrën 0 (zero) lekë, për shkak të mosekzistencës së tij dhe rrjedhimisht mos ushtrimit të aktivitetit në këtë periudhë të vitit.

III.1.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik “Ana Dulo” p.f. rezulton se xhiro në vlerë mesatare për periudhën e kërkuar në dokumentat e procedurës

së prokurimit është në vlerën 2.102.810 lekë, pra më e vogël se vlera 3.333.330 lekë, vlerë kjo sa fondi limit i kësaj procedure prokurimi.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, bazuar në dokumentacionin e paraqitur (si mësipër analizuar), kriteri për xhiron, nuk përmbushet në vlerë nga operatori ekonomik “Ana Dulo” p.f., për tre vitet e fundit financiare në përputhje me parashikimet ligjore të sipërcituara. Komisioni vlerëson se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “La Boheme” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, me nr. REF-74951-03-29-2017, me objekt “Një Piano për Qytetin e Artit (Dega Ekonomike e Kultures)”, me fond limit 3.333.330 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 10.04.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Ana Dulo” p.f. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “La Boheme” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 830 Protokolli

Datë 26.04.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

